

Nr. KPH/171/2025

Datumi: 21/03/2025

ODA EKONOMIKE | KOSOVA CHAMBER
E KOSOVËS | OF COMMERCE



ODA EKONOMIKE - KOSOVA CHAMBER
E KOSOVËS OF COMMERCE
NO: 51
21 03 2025
PRISHTINE

Për: **Institucionin e Avokatit të Popullit**

Nga: **Oda Ekonomike e Kosovës**

Lënda: **Kërkesë për dërgimin e vendimit të ZRRE-së në Gjykatën Kushtetuese**

Datë: **21.03.2025**

Të nderuar,

Oda Ekonomike e Kosovës ka mbajtur tryezë diskutimi me biznese mbi zhvillimet e fundit në sektorin e energjisë, në veçanti njoftimin e Zyrës së Rregulatorit të Energjisë (ZRRE) për hapjen e tregut të energjisë elektrike.

Në këtë takim morrën pjesë rrëth 100 biznese nga sektorë të ndryshëm.

Bizneset kanë ngritur shqetësimë të konsiderueshme lidhur me detyrimin për kalimin në tregun e hapur të energjisë elektrike dhe kanë kërkuar nga qeveria shtyrjen e afatit për një vit.

Kjo kërkesë vjen si pasojë e sfidave të shumta me të cilat po përballen ndërmarrjet, përfshirë kostot e larta të energjisë, pasigurinë në treg dhe nevojën për një periudhë tranzicioni më të gjatë.

Arsyet e kërkesës për shtyrje të afatit janë si më poshtë:

1. Kosto të larta dhe pasiguri në çmime – Bizneset argumentojnë se dalja nga tregu i rregulluar mund të sjellë rritje të ndjeshme të kostove të energjisë, duke ndikuar drejtpërdrejt në qëndrueshmërinë e tyre financiare.
2. Mungesë e informimit dhe infrastrukturës – Shumë kompani nuk janë të përgatitura për këtë kalim dhe kanë nevojë për më shumë kohë për t'u përshtatur me modelin e tregut të lirë.
3. Efektet në konkurrencën dhe stabilitetin e tregut – Një kalim i menjëherëshëm mund të krijojë një situatë ku bizneset më të vogla penalizohen më shumë, duke ndikuar negativisht në konkurrencë.

Përveç kërkesës së lartpërmendor, kërkesë tjetër lidhur me këtë vendim është edhe të mos caktohet një numër i përcaktuar i punonjësve apo një prag mbi vlerën e qarkullimit, si kritere për daljen në treg të hapur.

Kufizimi i kalimit në tregun e hapur duke u bazuar në numrin e punonjësve apo vlerën e qarkullimit penalizon një pjesë të bizneseve, duke krijuar një situatë të pabarabartë.

Energjia është një produkt strategjik, dhe të gjitha kompanitë duhet të kenë të njëjtat mundësi për të përzgjedhur furnizuesin e tyre pa u ndikuar nga kritere të tillë.

Ne vlerësojmë se mungesa e fleksibilitetit në këto rregulla mund të krijojë përjashtime të padrejta dhe të ndikojë në konkurrencën e ndershme mes bizneseve.

Duke marrë parasysh këto shqetësimë, bizneset i bëjnë thirrje ZRRE-së që të shqyrtojë mundësinë e shtyrjes së afatit për kalimin në tregun e hapur të energjisë me të paktën një vit. Një periudhë tranzicioni më e gjatë do t'u lejonte kompanive të përshtatin strategjitet e tyre dhe të shmangin goditjet e papritura financiare.

Duke marrë parasysh këto shqetësimë dhe rëndësinë e ruajtjes së të drejtave kushtetuese, ne kërkojmë që Avokati i Popullit, në përputhje me kompetencat ligjore – kushtetuese në emër të interesit publik të inicojë një procedurë për dërgimin e këtij vendimi në Gjykatën Kushtetuese për shtyrjen e afatit se paku një vit për implementimin e tij.

Ne besojmë se ky hap do të kontribuonte në mbrojtjen e interesit publik dhe do të ndihmonë në krijimin e një ambienti më të drejtë dhe më të qëndrueshëm për të gjithë qytetarët dhe bizneset në vendin tonë.

Kjo kërkesë vjen në emër të interesit të përbashkët të komunitetit të biznesit dhe shpresojmë se ZRRE do të marrë konsideratë serioze këto shqetësimë. Ne besojmë se një dialog i hapur dhe konstruktiv është thelbësor për të siguruar një kalim të suksesshëm dhe të qëndrueshëm në tregun e hapur të energjisë.

Ju falënderojmë dhe shpresojmë në mbështetjen tuaj në këtë çështje të rëndësishme për komunitetin e biznesit.

Me respekt,

Oda Ekonomike e Kosovës
Kryetar

Lulzim Rafuna



Adresa: Nëna Terezë, Nr:20, 10000 Prishtina – KOSOVË
Tel: + 383 (0) 38 224 741, Tel & Fax +383 (0) 038 224 299
info@oek-kcc.org, www.oek-kcc.org